



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 3/3 Prot.

Vlorë më, 06 . 01 . 2022

VENDIM
Nr. 3, DATË 05.01.2022

**PËR AFATET E PAGESËS SË TARIFËS SË STUDIMIT TË PROGRAMIT TË
CIKLIT TË TRETË TË STUDIMEVE "DOKTORATË" NË "STUDIME
GJUHËSORE, LETRARE E KULTURORE"**

Mbështetur në nenin 3, pika 3, shkronja ç në Ligjin nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenin 25, pika 1, shkronja i, në Statutin e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë", si dhe referuar shkresës së MAS me nr. 6304/2 prot., datë 16.12.2021, Senati Akademik, në mbledhjen e datës 05.01.2022,

VENDOSI:

1. Tarifa e studimit të programit të ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë" në "Studime gjuhësore, letrare e kulturore" të paguhet gjatë tre viteve të para të kohëzgjatjes së programit të studimit në masën 200, 000 lekë.
2. Pagesa vjetore e tarifës së studimit të paguhet në dy këste, në fillim të çdo semestri për vitin akademik respektiv, në masën 100, 000 lekë.
3. Ky vendim i përcillet Bordit të Administrimit për miratim të mëtejshëm.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

NËNKRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. As. Xhiliola AGARAJ (SHEHU)

